



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1022/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Naime Ahmeti, në çështjen juridike kontestuese të paditëses V. S. nga P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson N. H. avokat nga P., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS sh.a me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A. K., me objekt të padisë, vërtetimi i marrëdhënies së punës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë – publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqës me datë 04.02.2021, morri këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tersi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditëses V. S. nga P., me të cilën ka kërkuar, që të anulohet si jo i ligjshëm njoftimi nr.41 i datës 30.03.2016, vendimi nr.42 i datës 30.03.2016 dhe vendimi i Bordit të Drejtorëve nr.3304 i datës 20.04.2016 dhe të detyrohet pala e paditur që paditësen ta kthej në punë dhe detyrat e punës që i ka kryer para largimit nga puna dhe me të njëjtën të lidhë kontratë pune me kohë të paaktuar me të gjitha të drejtat nga puna dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Duke ju referuar pohimeve në padi dhe deklarimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor, dhe fjalën përfundimtare, paditësja përmes të autorizuarit të saj ka kërkuar nga gjykata që të anulohet si jo i ligjshëm njoftimi nr.41 i datës 30.03.2016, vendimi nr.42 i datës 30.03.2016 dhe vendimi i Bordit të Drejtorëve nr.3304 i datës 20.04.2016 dhe të detyrohet pala e paditur që paditësen ta kthej në punë dhe detyrat e punës që i ka kryer para largimit nga puna dhe me të njëjtën të lidhë kontratë pune me kohë të paaktuar me të gjitha të drejtat nga puna . Më tutje ka shtuar se paditësja te e paditura ka pasur statusin e punëtorës me kohë të caktuar dhe se me njoftimin e palës së paditur theksohet se nuk do ti vazhdohet kontrata e punës që e ka pasur me afat të caktuar deri me datën 08.05.2016, duke marrë parasyshë punët dhe detyrat e punës që i ka kryer paditësja sipas kontratës së punës, të cilat sipas natyrës nuk kanë pasur karakter të përkohëshëm por të perhershëm, andaj ka konsideruar se me të njëjtën është dashur të lidhet kontratë pune me kohë të caktuar apo e njejta kontratë ti vazhdohet siq është përcaktuar edhe

me kontratën paraprake me mundësi vazhdimi. I ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura për mes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në përgjigjeje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura ka vepruar në harmoni me Ligjin e Punës, Aktet nënligjore, Rregulloreve të brendshme, kur paditëses nuk ia ka vazhduar marrëdhënien e punës. Kontrata e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës ka qenë në afat të caktuar dhe e nënshkruar me vullnetin e të dyja palëve. Ndërsa për vazhdimin e kontratës nevojitet po ashtu vullneti i të dyja palëve. Në seancë drejtë për drejtë gjykatës i ka dorëzuar parashtrësën me pretendimet me të zgjeruara, mbështetur në përgjigje ne padi. Po ashtu si provë me anë të kësaj parashtrëse gjykatës i ka dorëzuar edhe dy vendime të Bordit të të paditurës, si dhe analizën mbi riorganizimin e të paditurës KEDS me të cilën janë bërë ndryshimet në aspektin ekonomik, teknik dhe organizativ siç e parasheh edhe neni 70 par.1 nën paragrafi 1.1 si dhe nën paragrafi 1.3 i Ligjit të Punës, bazuar në këto i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për të vlerësuar drejtë dhe për të vërtetuar gjendjen faktike lidhur me çështjen juridike konkrete në shqyrtimin kryesor- publik të mbajtur me datë 04.02.2021, me propozimin e palëve gjykata bëri administrimin e provave të gjithmbarshme e si më të rëndësishme nxori: kontratën e punës nr.12490/3581 datë 18.06.2014, vendimin nr.42 datë 30.03.2016, njoftimin nr.41 datë 30.03.2016, ankesën nr.2930 datë 12.04.2016, vendimin nr.3304 datë 20.04.2016, Vendimi i Bordit Ekzekutiv date 22.09.2016, analiza mbi riorganizimin e KEDS 20.02.2016 dhe vendimi i Bordit Ekzekutiv datë 22.03.2016.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore,(LPK-së) arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga kontrata e punës nr.12490/3581 datë 18.06.2014, gjykata konstatoi se paditësja pranë të paditurës ka themeluar marrëdhënien e punës në kohë të caktuar prej dt.18.06.2014 deri më 07.05.2016, me mundësi vazhdimi, në nenin 11 të kontratës ka qenë e përcaktuar ndërprerja e marrëdhënies së punës në kohë të pacaktuar me njoftimin paraprakë, kurse në fund të kontratës palët janë pajtuar me kushtet e kontratës dhe të njëjtën e kanë nënshkruar.

Nga njoftimi nr.41 datë 30.03.2016, gjykata konstatoi se e paditura dy muaj para skadimit të afatit të kontratës së punës, ka njoftuar paditësen se nuk do ti vazhdohet kontrata e punës.

Me anë të vendimit nr.42 datë 30.03.2016, gjykata ka konstatuar se e paditura ka vendos që kontrata e punës nr.8026 e lidhur me paditësen nuk do të vazhdohet pas datës së skadimit 07.05.2016, me arsyetimin se e paditura në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt.22.03.2016, për arsye ekonomike, teknike dhe organizative, ka vendosur që të mos ju vazhdoj kontratën e punës me afat të caktuar.

Paditësja ka ushtruar të drejtën e saj, ankesën nr.2930 datë 12.04.2016, në afatin e përcaktuar, ndërsa e paditura me vendimin nr.3304 datë 20.04.2016, e ka refuzuar si të pa bazë ankesën e paditëses, me arsyetimin se e paditura ka vepruar konform nenit 67 par.1, pika 1.3 dhe nenit

72 par.2 të Ligjit të Punës, ku parashihet se kontrata e punës me afat të caktuar shuhet sipas ligjit.

Nga provat e administruara si më lartë, si dhe nga ballafaqimi dhe kontradiktorialiteti i palëve ndërgjyqës, gjykata gjeti se kërkesëpadia është e pabazuar sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se paditësja pranë të paditurës është punësuar sipas kontratës së punës nr.12490/3581 datë 18.06.2014, e cila ka qenë në kohë të caktuar prej dt.18.06.2014 deri më 07.05.2016.

Sipas kësaj kontrate e paditura ka vepruar ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 70 par.1 të Ligjit të Punës, pasi që paraprakisht e ka informuar dy muaj para se të mos i vazhdohet kontrata e punës dhe atë sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt. 22.03.2016.

Sipas dispozitës së nenit 67 par. 1 nënpar.1.3 të Ligjit të Punës është përcaktuar se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës.

Gjykata vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e paditëses, me të cilat thekson që paditësja edhe pse ka qenë me kontratë pune me kohë të caktuar, sipas natyrës së punës punët të cilat i ka kryer, nuk kanë pas karakter të përkohshëm por të përhershëm dhe se e paditura është dashtë të lidhë kontratë pune me kohë të caktuar apo që e njëjta kontratë ti vazhdohet siç është përcaktuar edhe me kontratën paraprake me mundësi vazhdimi dhe se e paditura paditëses i ka ndërprerë marrëdhënien e punës në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi, parimet e Kontratës së Përgjithshme Kolektive dhe Ligjit kundër Diskriminimit dhe Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut, kjo pasi që sipas dispozitës së përcaktuar më lartë kontrata e punës e paditëses është ndërprerë sipas fuqisë ligjore, me skadimin e kontratës së punës.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e mos vazhdimit të kontratës gjegjësisht ndërprerjen e saj iu referua dispozitave ligjore të Ligjit të Punës në Kosovë, ku në nenin 70 par.1 pika 1.6.1 janë parapara rrethanat nën të cilat mund të shkëputet kontrata e punës.

Gjykata vlerëson se kushtet e kontratës së lidhur në mes paditësit dhe të paditurës janë me dispozitat e cituara të Ligjit të Punës së Kosovës rrjedhimisht vendimi për shkëputjen e Marrëdhënies së punës është i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata vlerëson se sipas Ligjit të Punës së Kosovës, marrëdhënia e punës duhet të interpretohet në tersi si marrëdhënie kontaktuese dhe në as një mënyrë nuk mund të kuptohet si çështje statusore. Sipas vlerësimit të gjykatës themelimi i marrëdhënies së punës me kontratë dhe përcaktimi i kushteve të kontratës i referohet normave ligjore të karakterit diapozitiv që nënkupton të drejtën e palëve kontraktuese që vullnetshëm dhe lirishtë përcaktojnë kushtet e kontratës përfshirë dhe kohëzgjatjen e kontratës.

Në rastin konkret mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës me kontratë iu ka lejuar palëve të drejtën që lirishtë, por pa i cenuar dispozitat ligjore, t'i përcaktojnë kushtet e kontratës duke përfshirë edhe kushtet e kohëzgjatjes së punës e rrjedhimisht edhe faktin se marrëdhënia e punës përfundon me skadimi e kontratës së pune apo edhe për shkaqe të tjera.

Meqenëse e paditura ka lidhur kontratë punë me paditësin në kohë të caktuar, gjykata vlerëson se ky është një kushte i kontratës i ligjshëm pasi që është në harmoni me kushtet ligjore që përcakton ligji i punës në Kosovë, e rrjedhimisht edhe zgjidhja e kontratës është e ligjshme, duke gjetur se e paditura zgjedhjen e kontratës ia ka bërë konformë dispozitave ligjore të sipërpërmendura.

Pasi që zgjidhja e kontratës ishte në pajtim me kushtet e kontratës dhe me dispozitat ligjore , gjykata vlerëson se kërkesa e paditëses për anulimin e vendimit për njoftimi nr.41 i datës 30.03.2016, vendimi nr.42 i datës 30.03.2016 dhe vendimi i Bordit të Drejtorëve nr.3304 i datës 20.04.2016, është e pa bazuar.

Meqenës kërkesëpadia refuzohet, paditësja nuk ka të drejtë të kompensimit të shpenzimeve kurse e paditura nuk kërkoi shpenzimet . Gjkata lidhur me shpenzimet e procedurale vendosi konformë dispozitës së nenit 450 të LPK-së , ashtu që sejcila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit/eve 4, 5, 7, 8 dhe 10 lidhur me nenin 143 të Ligjit mbi procedurën kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.1022/16, me datë 04.02.2021

G j y q t a r j a,
Naime Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate